




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Cc:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë e Podujevës	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministre i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 05/07/2018
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Podujevës	020/770
Lloji i aktit:	Statuti i Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Statuti i Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009.
E miratuar më datë: 29.06.2018
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.07.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Agim Veliu, gradonačelnik Opštine Podujevo Fatmir Gashi, predsedavajuća Skupštine opštine Podujevo	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenta u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>za. b.f. [signature]</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS - <i>[signature]</i>	Datum, 5.07.2018
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Podujevo	Br.020-770
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbe Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je zahtev za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravikao u nastavku:

Statut opštine br. 01-020/01-0050862/18 za dopunu i izmenu Statuta opštine br. 01-1/298-10 od dana, 12.oktobar 2009.
Usvojena dana, 29.06.2018. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 4.07.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom smislu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni učinak.


Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS



STATUTI PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS NR.01-1/298-10 TË DATËS 12 TETOR 2009

Podujevë, 29 qershor 2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.031-040 dhe neneve 15 paragrafi 2 shkronja a), 89 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nr.01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009, si dhe në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.01-020/04-0014922 të datës 28 shkurt 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2018, miratoi,

**STATUTIN
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E
STATUTIT TË KOMUNËS NR.01-1/298-10 TË DATËS 12 TETOR 2009** i plotësuar
dhe ndryshuar me Vendimet e Kuvendit të Komunës nr.01/15-10 të datës 30 janar 2012,
dhe nr.01/42-10 të datës 29 shkurt 2012

Neni 1

Neni 4 i Statutit bazë, ndryshohet – harmonizohet si vijon: “Selia e Komunës është në Podujevë, rruga “Nuh Gashi” nr.49”.

Neni 2

Neni 6.2. i Statutit bazë, teksti ku thuhet: “Fshatrat e Komunës së Podujevës janë” riformulohet si vijon: “Qyteti dhe fshatrat e Komunës së Podujevës janë”.

Neni 3

Neni 10 i Statutit bazë, riformulohet si vijon: “Qytetar i Komunës është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës që jeton në territorin e Komunës së Podujevës”.

Neni 4

Neni 30.2 i Statutit bazë, ku thuhet “Kuvendi ka 41 këshilltarë”, ndryshohet dhe atë: “Kuvendi ka 35 këshilltarë/e”.

Neni 5

Paragrafët 33.2, 33.3 dhe 33.4, të statutit bazë, fshihen në tërësi.

Neni 6

Neni 35 i Statutit bazë, plotësohet edhe me dy (2) paragrafë (35.6 dhe 35.7), dhe atë:
1. Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në paragrafin 35.5 të Statutit bazë, shkohet në votimin e tretë.
Në votimin e tretë, Kryesues i Kuvendit të Komunës zgjedhet kandidati i cili merre më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.
2. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës përsëritet.

Neni 7

Pas nenit 38 të Statutit bazë, shtohen dy (2) nene (neni 39 dhe neni 40), si vijon:

1. **Mbledhjet Urgjente** – Thirren në rast të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave tjera urgjente në Komunë. Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente të Kuvendit të Komunës. Procedurat për thirrjen e mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve tjera të Kuvendit të Komunës.

2. **Mbledhjet Solemne** – Mund të mbahen për raste të veçanta, festa zyrtare shtetërore, festa zyrtare të Komunës dhe solemnitete tjera. Mbledhjet solemne thirren nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës. Mbledhja solemne thirret së paku një (1) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

3. Ndërsa neni 39 i Statutit bazë, kalon sipas renditjes, përkatësisht bëhet 41, si dhe nenet vijuese vazhdojnë sipas numrit rendor.

Neni 8

Neni 42.4 i Statutit bazë, bëhet 42.2 në pjesën e fundit ku thuhet „.... ndryshe me këtë Statut. Reformulohet si vijon: “.....ndryshe me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut”.

Neni 9

Neni 43.2 i Statutit bazë, riformulohet si vijon:

“Procesverbalin e mban një nëpunës civil i autorizuar”.

Neni 10

Neni 48 i Statutit bazë, plotësohet dhe ndryshohet si vijon:

Komitetet tjera:

Kuvendi i Komunës themelon edhe komitete tjera sipas nevojës:

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Komiteti për Arsim
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik
- Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Komiteti për Kulturë Rini dhe Sport
- Komiteti për Pronë
- Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Neni 11

Neni 50 i Statutit bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Komiteti për Arsim - Është përgjegjës për fusha që ka të bëjë me edukimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe kopshtet e fëmijëve, themelimin dhe funksionimin e institucioneve mësimore. Ky komitet monitoron punën e Drejtorisë së Arsimit, bënë rekomandime në bazë të ligjeve në fuqi, si dhe merret me çështje tjera në kuadër të fushës së arsimit.

Neni 12

Neni 52 i Statutit bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Në emërtimin e Komitetit dhe në kuadër të nenit tjetër "kadastër" fshihet, ndërsa në paragrafin 52.3, pjesa tekstuale ".....shfrytëzimin e tokës dhe.....", fshihet.

Neni 13

Pas nenit 52 të Statutit bazë, shtohen tri (3) nene sipas renditjes (neni 55, neni 56 dhe neni 57), si vijon:

1. **Komiteti për Kulturë Rinë dhe Sport** - Është përgjegjës për fushën që ka të bëjë me Kulturën Rinë dhe Sportin në Komunën e Podujevës, lidhur me funksionimin e objekteve sportive dhe kulturore siç janë Teatri, biblioteka, kinematë komunale, stadiumet sportive e të tjera të ngjashme. Ky Komitet monitoron punën e Drejtorisë së Kulturës Rinë dhe Sportit për çështjet që kanë të bëjnë me politikën kulturore, rinore dhe sportive dhe të bëjë rekomandime për tushat në tjalë.

2. **Komiteti për Pronë** - Është përgjegjës për fushën që ka të bëjë me pronën, duke mos u kufizuar edhe për fushën që ka të bëjë me kadastrin dhe gjeodezinë, lidhur me banimin, ndërtesat publike, shfrytëzimin dhe menaxhimin e pronave publike dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë. Ky Komitet monitoron punën e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë për çështje që kanë të bëjnë me politikën që janë në kompetencë dhe fushveprimtari të kësaj Drejtorie.

3. **Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural** - është përgjegjës për fushën që ka të bëjë me bujqësinë pylltarinë dhe zhvillimin rural, lidhur me ngritjen, avancimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore të bujqësisë, ruajtjen dhe mbrojtjen e pylltarisë si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin rural në territorin e Komunës. Ky Komitet monitoron punën e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për çështje që janë në kompetencë dhe fushveprimtari të kësaj Drejtorie.

4. Neni 53 i Statutit bazë, kalon sipas renditjes, dhe bëhet 58, ndërsa kapitulli VIII bartet pas nenit 58 të Statutit bazë dhe nenet vijuese vazhdojnë sipas numrit rendor.

Neni 14

Neni 62.3 i Statutit bazë, riformulohet si vijon: "Sistematizimi dhe përshkrimi i vendeve të punës të Nëpunësve Civil në kuadër të Komunës rregullohet me akt të veçantë të Kryetarit të Komunës"

Neni 15

Neni 65 i Statutit, ku thuhet "Zyrat e Vendit" zëvendësohet me:
"Zyra e Gjendjes Civile".

Neni 16

Neni 71 i Statutit, ndryshohet dhe riformulohet, si vijon:

1. Kuvendi i Komunës themelon Komitete Konsultative në propozim të Kryetarit të Komunës, anëtarëve të Kuvendit dhe OJQ-ve / Shoqërisë civile, dhe janë trupa ndihmës të Kuvendit dhe roli i tyre është ndihmojnë organet e Komunës të jenë më transparente, më etikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.

2. Komitetet Konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve / Shoqërisë Civile të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse, të cilët përzgjidhen sipas konkursit publik të shpallur nga Kuvendi i Komunës pas propozimit të Panelit Përzgjedhës të themeluar nga Kuvendi.
3. Mandati i Komiteteve Konsultative është 4 vjet nga themelimi. Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe Komitete Konsultative ad-hoc për çështje të caktuara.
4. Numri i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 5 deri në 7 anëtarë, dhe duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor.
5. Komitetet mbajnë mbledhje sipas nevojës, por jo më pak se 6 takime në vit.
6. Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushveprimtarit e ndryshme në pajtim me këtë Statut, përfshirë, për rregullore të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Kuvendit dhe Komiteteve të përhershme, paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara dhe çështje tjera me nevojë të cilat duhet të merren parasysh nga Kuvendi i Komunës për zhvillimin e politikave lokale.
7. Komitetet Konsultative obligohen të dorëzojnë në Kuvendin e Komunës, raport vjetor për punën e tyre.

Neni 17

Neni 74 i Statutit bazë,

1. Paragrafi 1 i nenit 74, riformulohet si vijon: "Aktet normative të Kuvendit të Komunës bëhen publike konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, përveç atyre publikimi i të cilave kufizohet me legjislacionin për qasje në dokumente zyrtare".
2. Paragrafi 2 i nenit 74, pjesa tekstuale ku thuhet "..... sipas dispozitave nga neni 72.3 të këtij Statuti" fshihet.

Neni 18

Neni 75.2 i Statutit bazë, riformulohet si vijon: "Njësia apo zyrtari përgjegjës për komunikim me qytetarë, obligohet të veprëj sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi për qasje në dokumente zyrtare".

Neni 19

Neni 78 i Statutit bazë,

1. Paragrafi 1 i nenit 78, riformulohet, si vijon: "Shqyrtimi administrativ i akteve të Komunës ushtrohet në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin".
2. Paragrafi 2 i nenit 78, riformulohet, si vijon: Nuk mund të ushtrohet ndonjë shqyrtim paraprak nëse nuk parashihet ndryshe me ligjin dhe këtë Statut.
3. Paragrafi 3 i nenit 78, në përfundim të tekstit ku thuhet: "..... në pajtim me këtë ligj" riformulohet si vijon: "..... në pajtim me ligjin dhe këtë Statut".

Neni 20

Neni 85 i Statutit, pjesa tekstuale ku thuhet: "..... Gjykata e Qarkut që është kompetente" riformulohet si vijon: "..... Gjykata kompetente".

Neni 21

Neni 88 i Statutit, pjesa tekstuale ku thuhet: ".....Ligjit për procedurën administrative, riformulohet si vijon: ".....Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative në fuqi".

Neni 22

Pas miratimit të këtij Statuti, bëhet spastrimi përkatësisht inkorporimi i plotësimeve dhe ndryshimeve në Statutin bazë të Komunës së Podujevës, përfshirë edhe aspektin teknik, si dhe duke marrë për bazë edhe ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Vendimet e Kuvendit të Komunës, nr.01/15-10 të datës 30 janar 2012, dhe nr.01/42-10 të datës 29 shkurt 2012.

Neni 23

Interpretimin autentik të këtij Statuti e bënë Kuvendi i Komunës.

Nr. 01-020/01-0050862/18
Podujevë
29 qershor 2018



Presuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

SKUPŠTINA OPŠTINE

STATUT
ZA DOPUNU I IZMENU STATUTA OPŠTINE BR. 01-1/298-
10 DANA 12 OKTOBRA 2009

Podujevo, 29 juni 2018

Shodno člana 12 st. 2 slovo a) Zakona lokalne Samouprave br.03/I -040 i članova 15 st. 2 slovo a), 89 st. 1 Statuta Opštine br.01-1/298-10 dana 12 oktobra 2009, kao i u skladu sa Odlukom Skupštine Opštine br.01-020/04-0014622 dana 28 februara 2018, Skupština Opštine Podujevo, na održanoj sednici dana 29 juna 2018, usvojila:

STATUT

ZA IMENE I DOPUNU STATUTA OPŠTINE BR. 01-1/298-10 DANA 12 OKTOBRA 2009 sa izmenama i dopunama Odlukama Skupštine Opštine br. 01-15-10 dana 30 januara 2012 i br. 01/42-10 dana 29 februara 2012

Član 1

Član 4 osnovnog Statuta, menja se - uskladuje kao sledeće: "Sedište Opštine je u Podujevo, ul. "Nuhi Gashi" br. 49."

Član 2

Član 6.2 osnovnog Statuta, tekst gde se kaže: „sela opštine Podujevo su..“ re formuliše kao sledeće: „Grad i sela optine Podujeva su..“

Član 3

Član 10 osnovnog Statuta reformuliše kao sledeće: Građanin Opštine je svako lice koji je stalni građanin Republike Kosova koji živi na teritoriju Opštine Podujevo..

Član 4

Član 30.2 osnovnog Statuta gde se kaže: „Skupština ima 41 savetnika..“ menja se u to: „Skupština broji 35 savetnika..“

Član 5

Stavovi : 33.2, 33.3 i 33.4 osnovnog Statuta brišu se potpuno.

Član 6

Član 35 osnovnog Statuta, dopuni se sa dva stava (35.6 i 35.7) i to:

1.Ako i posle drugog glasanja ni jedan od kandidata nije dobio traženu većinu kao u st. 35.5 osnovnog Statuta, ide se na treće glasanje.

Na trećem glasanju, Predsedavajući SO-e bira kandidata koji ima više od polovine glasova prisutnih članova i koji glasaju za predlog u sednici SO-e

2.Ako i posle trećeg glasanja ne izabere Predsedavajući SO-e tada ceo proces za izbor Predsedavajućeg SO-e se ponovi.

Član 7

Posle člana 38 osnovnog Statuta, dodaju se dva člana (član 39 i član 40) kao sledeće:

1. Hitne sednice- Pozivaju se u slučaju prirodnih nepogoda i drugih okolnosti u Opštinu. Predsedavajući Skupštine i Predsednik Opštine imaju pravo zvanja hitnih sastanka SO-e. Procedure za poziv hitnih sastanaka ne primenjuju se kao u slučaju drugih sednica SO-e.
2. Svečane sednice- Mogu se održavati za posebne slučajeve, zvaničnih državnih praznika, zvaničnih praznika Opštine, i drugih svečanosti. Svečane sednice se pozivaju od strane Predsedavajućeg Skupštine i Predsednika Opštine. Svečana sednica se poziva najmanje dan pre održavanja
3. Dok član 39 osnovnog Statuta, prelazi po redosledu odnosno postaje 41 kao i sledeći članovi nastavljaju se po rednom broju.

Član 8

Član 42.4 osnovnog Statuta, postaje 42.2 u zadnjem delu gde se kaže..... inače ovim Statutom. Reformuliše se kao sledeće..... inače po zakonodavstvom na snazi i ovim Statutom..

Član 9

Član 43.2 osnovnog Statuta, reformuliše se kao sledeće:
"Zapisnik održava jedan ovlašćeni civilni zvaničnik"

Član 10

Član 48 osnovnog Statuta dopuni se i menja kao u sledeće:

Ostali Komiteti:

Skupština Opštine osnuje i drugih komiteta po potrebu:

- Komitet za Zdravstvo i Socijalnog Blagostanja
- Komitet za Obrazovanje
- Komitet za ekonomski razvoj
- Komitet za Urbano Planiranje i zaštitu Sredine
- Komitet za Omladinu, Kulturu i Sport
- Komitet za Imovinu
- Komitet za Poljoprivredu, Šumarstvo i Ruralni Razvoj

Član 11

Član 50 osnovnog Statuta, menja se i dopuni se tekstem kao sledeće..

Komitet za Zdravstvo- je odgovoran za oblast koja se tiče predškolske edukacije, osnovne, srednje i dečjih vrtića osnivanje i funkcionisanje nastavnih institucija. Ovaj Komitet monitoriše rad Direkcije Obrazovanja, daje preporuke na osnovu zakona na snazi, i bavi se drugim pitanjima u oblasti obrazovanja.

Član 12

Član 52 osnovnog Statuta, menja se i dopunjava tekstem kao u sledeće:

U naziv Komiteta u okviru člana reč „katastar„ briše se, dok u st. 52.3 tekstualni deo „korišćavanje zemljišta i „ briše se.

Član 13

Po članu 52 osnovnog Statuta, dodaju se tri(3) člana po redosledu član 55, član 56 i član 57) kao sledeće:

1. Komitet za Kulturu Omladinu i Sport- je odgovoran za oblast koja se tiče Omladine, Kulture i sporta u opštinu Podujevo u vezi funkcionisanja sportskih i kulturnih objekata kao što su Pozorište, Biblioteka, opštinski bioskopi, sportski stadioni i drugih sličnih. Ovaj Komitet nadgleda rad Direkcije K.O.S za pitanja koja se tiču kulturnih sportskih i onih omladinskih politika preporučenih u navedenim oblastima.
2. Komitet za Imovinu- je odgovorana za oblast koja se tiče imovine, ne održavajući se ne samo u oblastima katastra i geodezije u vezi stanovanja, javne zgrade, korišćavanje i poslovanje javnih imovina i drugih pitanja koja se tiču ove oblasti. Ovaj Komitet nadgleda rad Direkcije I.K.G za pitanja koja se tiču nadležnosti i delovanja ove Direkcije.
3. Komitet za Poljoprivredu Šumarstvo i Ruralni Razvoj- je odgovorana za oblast koja se tiče poljoprivrede, šumarstva, ruralnog razvoja, u vezi podizanja, unapređenja i primenu razvojnih politika poljoprivrede, šumarstva čuvanje i zaštite šuma kao i drugih pitanja koja se tiču ruralnog razvoja na teritoriju Opštine. Ovaj Komitet nadgleda rad DPSRR za pitanja koja su kompetencija ove Direkcije
4. Član 53 osnovnog Statuta, ide po redosledu i postaje 58 dok poglavlje VIII se prenosi posle člana 58 osnovnog Statuta i narednih članova po rednim brojem.

Član 14

Član 62.3 osnovnog Statuta reformuliše se kao sledeće: Sistematizacija i prepis radnih mesta civilnih službenika u okviru Opštine reguliše se posebnim aktom Predsednika Opštine.

Član 15

Član 65 Statuta gde se kaže „mesni zvaničnik„ zamenjuje se sa „kancelarija civilnog Stanja„.

Član 16

Član 71 Statuta menja se i reformuliše kao sledeće:

1. Skupština Opštine osnuje Konsultativnih Komiteta po predlogu Predsednika Opštine, članovima Skupštine i NVO, civilnog društva i jesu pomoćne trupe Skupštine i njihova uloga je da pomognu organe Opštine da postaju transparentni, efikasniji i daju više računa građanima

2. Konsultativni Komiteti se čine od građana i predstavnika NVO/ građanskog društva koja trebaju biti poznavaoци odgovarajućih oblasti koja se biraju prema javnom konkursu objavljenog od strane SO-e po predlogu Izbornog panela osnivanog od strane Skupštine
3. Mandat konsultativnih Komiteta je 4 godine od osnivanja . SO-e može osnivati i ad hoc Konsultativnih Komiteta za određena pitanja
4. Broj članova Konsultativnih Komiteta je 5 do 7 člana i treba reflektovati rodno predstavljanje.
5. Komiteti održavaju sastanke prema potrebama ali ne manje od 6 sastanka godišnje.
6. Konsultativni Komiteti mogu dostaviti predlog iz raznih delokruga u skladu sa ovim statutom, obuhvatajući i razne pravilnike, razna istraživanja, mišljenja i ideja oko inicijativa Predsednika Opštine, Skupštine i stalnih Komiteta, podnesu gledišta i mišljenja građana kod Predsednika Opštine i SO-e, daju predlog za rešavanje identifikovanih problema i drugih potrebnih pitanja koja treba uzimati u obzir od strane SO-e za razvoj lokalnih politika.
7. Konsultativni Komiteti se zadužuju da dostave SO-e godišnji izveštaj o njihovom radu.

Član 17

1. St. 1 člana 74. reformuliše se kao sledeće: Normativni akti SO-e postaju javni shodno zakonskih odredbi na snazi, osim onih čije objavljivanje označava sa zakonodavstvom za pristup u službeni dokumentaciju..
2. St.2 član 74 tekstualni deo gde se kaže.. prema odredbama iz člana 72.3 ovog Statuta briše se.

Član 18

Član 75.2 osnovnog Statuta reformuliše se kao što sledi: Jedinica ili odgovorni zvaničnik za odnose sa građanima, dužan je da postupi po zakonskim odredbama i podzakonskim aktima na snazi za pristup u javnim dokumentima..

Član 19

Član 78 osnovnog Statuta

1. St. 1 član 78 reformuliše se kao sledeće: Administrativno razmatranje Opštinskih akata vrši se u skladu sa Ustavom i zakonom..
2. St.2 član 78., reformuliše se kao sledeće: ne može se vršiti prethodno razmatranje ako se ne predviđa drugačije zakonom i ovim Statutom.
3. St. 3 član 78 na kraju teksta gde se kaže.. u skladu sa ovim zakonom.. reformuliše se kao sledeće.. u skladu sa zakonom i ovim Statutom..

Član 20

Član 85 Statuta, tekstualni deo gde se kaže: „ Okružni sud koji je ovlašćen, reformuliše se kao što sledi: „Ovlašćeni sud...

Član 21

Član 88 Statuta tekstualni deo gde se kaže: „ zakona za administrativnu proceduru, reformuliše se kao sledeće: „ zakona za opštu administrativnu proceduru na snazi...

Član 22

Posle usvajanja ovog Statuta, vrši se čišćenje odnosno inkorporacija dopuna i izmena u osnovnom Statutu Opštine Podujevo, obuhvatajući i tehnički aspekt kao i uzimajući u obzir izmene i dopune učinjene Odlukama Skupštine Opštine br. 01/15-10 dana 30 januara 2012 i br. 01/42-10 dana 29 februar 2012

Član 23

Ulatentičnu interpretaciju ovog Statuta vrši Skupština Opštine

Br.01-020/01-0050862/18
Podujevo,
29 jun 2018



Predavajući Skupštine
Fatmir Gasiri



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

STATUTI I KOMUNËS SË PODUJEVËS

(Teksti i spastruar sipas Statutit nr.01-020-01-0050862-18 të datës 29 qershor 2018, për
plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës nr.01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009,
plotësuar dhe ndryshuar me Vendimet e Kuvendit të komunes nr.01/15-10 të datës 30 janar
2012; dhe nr.01/42-10 të datës 29 shkurt 2012)

Podujevë,
29 qershor 2018

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja a) dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03 L-040 Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2018, miraton,

STATUTIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Statuti parasheh sigurimin e zbatimit të përgjegjësisë të Komunës, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisjen lokale të Republikës së Kosovës.
3. Statuti përkufizon statusin juridik të Komunës, kompetencat dhe parimet e përgjithshme financiare të Komunës, organizimin dhe funksionimin e organeve të Komunës, marrëdhëniet brenda Komunës dhe bashkëpunimin ndërkomunal, marrëdhëniet e Komunës me Nivelin qendror dhe dispozitat përfundimtare.

KAPITULLI II

Neni 2

Komuna

1. Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një ose më shumë komunitete të qytetarëve në territorin e caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.
2. Organet e Komunës kujdesen që qytetarët t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim të gëzojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta në shërbimet komunale.
3. Komuna duke zbatuar politikat dhe praktikën mbështet bashkëjetesën ndërmjet qytetarëve dhe krijon kushte të përshtatshme, duke iu mundësuar të gjitha komuniteteve për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.
4. Komuna mund të lidhë marrëveshje me fshatrat, lagjet dhe vendbanimet në territorin e saj për t'iu ofruar shërbime qytetarëve.
5. Organet e Komunës iu mundësojnë qytetarëve pjesëmarrje në aktivitetet e Komunës, si dhe iu përgjigjen të njëjtëve sipas formave të parapara ligjore.

Neni 3

Statusi i Komunës

1. Komuna është person juridik dhe në mes tjerash ka kompetenca që:
 - 1.1. të padisë dhe të padihet në gjykata
 - 1.2. të posedoj dhe të menaxhoj pasurinë
 - 1.3. të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët

- 1.4. të lidhë kontrata
- 1.5. të punësojë stafin, dhe
- 1.6. të angazhohet në aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë të saj.

Neni 4

Selia e Komunës është në Podujevë, rruga "Nuh Gashi" nr.49.

Neni 5

Territori dhe kufijtë e Komunës janë përcaktuar me dispozitat e Ligjit për kufijtë administrativ të komunave dhe mund të ndryshohen vetëm në përputhje me Ligjin e cekur.

Neni 6

1. Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejshë Komuna) është njësi territoriale, dhe e përbëjnë: qyteti i Podujevës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

2. Qyteti dhe fshatrat e Komunës së Podujevës janë:

- | | | |
|--------------------------|-------------------|----------------|
| 1- Bajçinë | 28- Siboc i Epërm | 55- Peran |
| 2- Balloc | 29- Gërdoc | 56- Podujevë |
| 3- Baranë | 30- Halabak | 57- Popovë |
| 4- Batllavë | 31- Hërticë | 58- Potok |
| 5- Bellopojë | 32- Kaçybeg | 59- Përpellac |
| 6- Bllatë | 33- Kalaticë | 60- Radujevë |
| 7- Bradash | 34- Sallabujë | 61- Rakinice |
| 8- Brainë | 35- Kunushec | 62- Reçicë |
| 9- Breçë | 36- Kërpimëh | 63- Rep |
| 10- Bërvenik | 37- Kushevicë | 64- Revuç |
| 11- Buricë | 38- Lladoc | 65- Shaikoc |
| 12- Dobërdol | 39- Llaushë | 66- Shakovicë |
| 13- Dobratin | 40- Letanë | 67- Sylevicë |
| 14- Dumnicë e Poshtme | 41- Livadicë | 68- Sllatinë |
| 15- Ulapashicë e Poshtme | 42- Llugë | 69- Shtedim |
| 16- Pakashicë e Poshtme | 43- Lluzhan | 70- Surdull |
| 17- Lupç i Poshtëm | 44- Majac | 71- Surkish |
| 18- Siboc i Poshtëm | 45- Muhazob | 72- Svecël |
| 19- Dumosh | 46- Metergoc | 73- Tërmas |
| 20- Dyz | 47- Merdar | 74- Tërmasvicë |
| 21- Dvorishtë | 48- Meteli | 75- Turucicë |
| 22- Gllamnik | 49- Miroc | 76- Velikareke |
| 23- Godishnjak | 50- Murgull | 77- Zakut |
| 24- Dumnicë e Epërme | 51- Obrangj | 78- Zhin |
| 25- Ulapashicë e Epërme | 52- Orllan | |
| 26- Pakashicë e Epërme | 53- Pollatë | |
| 27- Lupç i Epërm | 54- Penuh | |

3. Komuna ndahet në njësi kadastrale. Qyteti dhe secili fshat përbëjnë një njësi kadastrale.

Neni 7

Simbolet

1. Komuna ka simbolet e vetat: vulat, emblemen dhe flamurin komunal.
2. Simbolet e Komunës miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës dhe nuk u përmigjajnë simboleve tjera të komunave në Republikën e Kosovës.
3. Simbolet e Komunës miratohen apo ndryshohen me dy të tretën (2/3) e votave në Kuvendin e Komunës, pas diskutimit publik.
4. Komuna ka emblemen e vet.
5. Përdorimi i emblemes është e drejtë ekskluzive e Komunës dhe asnjë subjekt apo person nuk mund ta përdorë emblemen dhe as shenjat dhe simbolet tjera pa autorizim paraprak nga organi kompetent i Komunës.
6. Vulat e Komunës
7. Komuna ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit.
 - 7.1. Vula e rrumbullakët përmban tekstin:
 - rrethi i parë: Republika e Kosovës;
 - rrethi i dytë: Komuna e Podujevës;
 - rrethi i tretë:
 - në mes të vulës është emblema.
 - 7.2. Vula e protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë, me tekstin:
 - Republika e Kosovës;
 - Komuna e Podujevës;
 -;
 - nr., më
8. Vulat e Komunës të përshkruara në pikat a dhe b. tekstin duhet ta kenë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
9. Komuna e ka flamurin e vet.
10. Përmbajtja e drejta dhe mënyra e përdorimit të simboleve të Komunës përcaktohet me vendime të veçanta të Kuvendit të Komunës.

Neni 8

Festa e Komunës

Komuna ka ditën e festës së saj publike, Dita e Çlirimit të Podujevës, e cila festohet më 19 qershor për çdo vit. Me rastin e Ditës së Çlirimit të Podujevës, Kuvendi i Komunës përkujton Dëshmorët dhe viktimat e luftës të rënë për lirinë e Kosovës.

Neni 9

1. Kuvendi i Komunës jep shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.
2. Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies së shpërblimeve, të dekoratave dhe të mirënjohjeve.
3. Dhënia e shpërblimit ose mirënjohja në të holla, apo në vlerë të të hollave, nuk duhet ta tejkalojë shumën prej 200 €, përveç në rast se Kuvendi i Komunës merr vendim për një shumë më të lartë.

Neni 10

Qytetarët e Komunës

Qytetar i Komunës është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës që jeton në Komunën e Podujevës.

Neni 11

Gjuhët

1. Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë shërbyesit civil të Komunës.
2. Këshilltarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehën në gjuhën e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.
3. Në mbledhjet e Kuvendit, të komiteteve, dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.
4. Të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës shtypen në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.
5. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Komuna do të jenë në gjuhën e palës.
6. Supozohet se gjuha e palës është ajo në të cilën pala fillimisht i është drejtuar Komunës.
7. Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, duhet të jenë të shkruara në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.
8. Komunikimi me institucionet komunale, Institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet dhe organizatat tjera, bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
9. Çështjen e përdorimit të gjuhëve Kuvendi duhet ta rregulloj përmes rregullores së veçantë, konform Ligjit për përdorimin e gjuhëve të Republikës së Kosovës.

Neni 12

Në organet dhe shërbimet publike të Komunës sigurohet përfaqësimi proporcional i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe strukturës gjinore.

KAPITULLI III

Neni 13

Organet e Komunës

Organet e Komunës janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Neni 14

Aktet e organeve komunale

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore dhe akteve të përgjithshme të Komunës kanë të drejtë të miratojnë dhe të nxjerrin akte si dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre.

Neni 15

Aktet e Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës miraton akte brenda fushës së kompetencave të tij.
2. Aktet e Kuvendit të Komunës vlejnë në territorin e Komunës dhe janë
 - 2.1. Statuti i Komunës;
 - 2.2. Rregullorja e punës e Kuvendit të Komunës.
 - 2.3. Rregulloret komunale; dhe
 - 2.4. çdo akt tjetër i nevojshëm për funksionim efikas të Komunës.

3. Statuti i Komunës miratohet dhe mund të ndryshohet me, së paku, votim të dy të tretës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

4. Rregulloja e punës miratohet dhe mund të ndryshohet, me votimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 16

Aktet e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij.

Neni 17

Pasuria e Komunës

1. Komuna ka të drejtë të posedoj dhe menaxhoj pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj, të jap me qira nën kushtet që parasheh ligji, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

2. Komuna e mban dhe udhëheq regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e ka në shfrytëzim dhe posedim.

KAPITULLI IV

Kompetencat e Komunës

Neni 18

Komuna i ushtron kompetencat vetanake dhe të deleguara në përputhje me ligjin sipas parimit të subsidiaritetit.

Neni 19

Kompetencat vetanake

1. Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

1.1. zhvillimin lokal ekonomik;

1.2. planifikimin urban dhe rural;

1.3. shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;

1.4. zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;

1.5. mbrojtjen e mjedisit lokal;

1.6. ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;

1.7. përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;

1.8. ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;

1.9. promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut

1.10. ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;

1.11. ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse.

punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;

1.12. banimin publik;

1.13. shëndetësinë publike;

1.14. licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;

1.15. emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

1.16. ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;

1.17. turizmit;

1.18. aktivitetet kulturore dhe të lira;

1.19. çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër;

Neni 20

Kompetencat e deleguara

1. Institucionet e Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin, i delegojnë Komunës, kompetencat vijuese:

1.1. shënimet kadastrale;

1.2. regjistrimin civil;

1.3. regjistrimin e votuesve;

1.4. regjistrimin e biznesit dhe licencimin;

1.5. distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);

1.6. mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e Komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjtëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria;

2. Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI V

Buxheti i Komunës

Neni 21

1. Komuna ka buxhetin dhe financat e saj për financimin e kompetencave të saj.

2. Buxheti i Komunës përbëhet prej të hyrave vetanake: granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës; donacioneve dhe të hyrave të tjera.

3. Komuna në pajtim me ligjet, urdhëresat, udhëzimet dhe instruksionet krijon të hyra vetanake nga:

3.1. tariflat dhe ngarkesat,

3.2. të ardhurat dhe pasuria e Komunës,

3.3. gjërat komunale dhe

3.4. të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës komunale.

4. Buxheti dhe financat e Komunës rregullohen me Ligjin për financat lokale.

5. Buxheti i Komunës, në pajtim me dispozitat ligjore miratohet për një vit fiskal, e viti fiskal fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

6. Kërkesat thelbësore për menaxhimin publik, financiar dhe përgjegjëshmëritë e përcaktuara në legjislacionin qendror, zbatohen për të gjitha komunat.

Neni 22

Shërbimet komunale që ofrohen nga ndërmarrjet komunale

1. Në rastet ku shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet komunale, ato ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre Kuvendit të Komunës për miratim.
2. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal.
3. Komuna e kontrollon dhe e mbikëqyrë afarizmin financiar të ndërmarrjeve publike komunale dhe të të gjitha organizatave jofitimprurëse, të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna.
4. Në rastet kur një ndërmarrje ofron shërbime publike komunale për më shumë se një komunë, komunat themelojnë bord të përbashkët menaxhues për mbikëqyrje të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Neni 23

Auditimi i brendshëm

1. Komuna ka obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.
2. Komuna ka të drejtë për të themeluar një shërbim autonom të auditimit në Komunë, apo për të siguruar auditim të brendshëm nga një firmë e akredituar e auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 24

Auditimi i jashtëm

1. Niveli qendror bën auditimin e jashtëm të Komunës në baza vjetore, në pajtim me ligjin në zbatim të Auditorit gjeneral të Republikës së Kosovës.
2. Auditori ka të drejtë t'i shikoj të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat dhe dokumentet tjera, dhe mund të kërkoj ndonjë informata e cila atij i duhet për kryerjen e kontrollit.
3. Auditori i auditorit të gjitha raportet financiare të të gjitha organizatave të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna si dhe deklaratat financiare të ndërmarrjeve të Komunës.
4. Secili, mund t'i paraqesë ankesë auditorit lidhur me deklaratat financiare dhe çështjet tjera financiare të Komunës për të cilat auditori mund të bëjë hetime lidhur me to.
5. Auditori i dorëzon Kuvendit të Komunës raport me shkrim për çdo kontroll financiar, për të cilin Kuvendi i Komunës merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përmban raportin.
6. Kuvendi nuk mund ta refuzoj asnjë prej rekomandimeve pa arsye të mjaftueshme, të cilat duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.
7. Të gjitha raportet e auditorit dhe përgjigjet e autoriteteve lokale bëhen publike.

KAPITULLI VI

Bashkëpunimi ndërkomunal dhe aranzhmanet brendakomunale

Neni 25

Bashkëpunimi i Komunës me komunat tjera të Republikës së Kosovës

Komuna ka të drejtë të bashkëpunoj dhe krijoj partneritete me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda fushës së kompetencave të saj, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët në pajtim me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me ligjin.

Neni 26

Partneritetet e Komunës

1. Përgjegjësitë e Komunës në fushën e kompetencave të saj vetanake, me përjashtim të atyre të parapara në nenin 34.2 të këtij Statuti, mund të ushtrohen përmes partneriteteve të Komunës.
2. Aktivitetet e partneriteteve financohen nga buxheti i Komunës.
3. Partneritetet komunale mund t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për jetësimin dhe ushtrimin e bashkëpunimit funksional përmes, themelimit të një organi vendimmarrës, të përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, punësimit dhe shkarkimit të personelit administrativ dhe këshillëdhënës dhe vendimeve mbi nevojat për financim dhe nevojave të tjera operationale të partneritetit.
4. Vendimet për partneritetet iu nënshtrohen mbikëqyrjes së ligjshmërisë në pajtim me dispozitat e nenit 82 të këtij Statuti.

Neni 27

Të drejtat e Komunës për të formuar asociacione

1. Për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të saj dhe të përbashkëta, Komuna organizohet dhe merr pjesë në asociacionet që funksionojnë, në pajtim me ligjin.
2. Komuna mund t'iu bashkohen asociacioneve përfaqësuese të organeve vetëqeverisëse lokale të Republikës së Kosovës.
3. Aktin i inkorporues, dokumentet financiare të asociacioneve, informacionin për aktivitetet dhe kontributet e tyre buxhetore në asociacione Komuna duhet t'i bëjë publike.
4. Në pajtim me ligjin, asociacionet e tilla mund t'iu ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë trajnimin, ngritjen e kapaciteteve, ndihmën teknike dhe hulumtim në kompetencat komunale dhe rekomandimet politike.
5. Asociacionet e komunave të Republikës së Kosovës mund të bashkëpunojnë me asociacionet ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

Neni 28

Bashkëpunimi i Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane

1. Komuna mund të bëjë marrëveshje me fshatrat, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të Komunës.
2. Me aprovimin e Komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, vetë apo në mënyrë të kombinuar, mund të kryejnë aktivitete që bëjnë pjesë në përgjegjësitë dhe në kompetencat e Komunës. Në këtë rast, komunat ofrojnë burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.
3. Objekt i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane mund të jenë të gjitha çështjet që janë në kompetencë vetanake të Komunës, duke përfshirë:
 - 3.1. Planifikimin urban dhe rural;
 - 3.2. Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin;
 - 3.3. Shëndetësinë publike;
 - 3.4. Mbrojtjen lokale të ambientit;
 - 3.5. Turizmin;
 - 3.6. Hapësirave të hapura dhe varrezave;
 - 3.7. Aktiviteteve kulturore dhe sportive, etj.

4. Objekti i marrëveshjes nuk mund të jenë përgjegjësit e Kuvendit të Komunës të përcaktuar në nenin 34.2 të këtij Statuti.

5. Marrëveshja e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, duhet t'i përmbajë së paku këto elemente:

5.1. Objektin e marrëveshjes;

5.2. Kohëzgjatjen;

5.3. Përshkrimin e obligimeve për palët;

5.4. Dinamikën e realizimit të punëve; dhe

5.5. Koston financiare.

6. Punët nga këto marrëveshje bashkëpunimi mund të financohen në ndonjë nga mënyrat e mëposhtme:

6.1. nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;

6.2. nga Komuna;

6.3. nga donatorë; dhe

6.4. me financim të përbashkët.

7. Marrëveshjet të cilat i lidh Komuna me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane duhet të miratohen nga Kuvendi.

Neni 29

Organizimi i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Kuvendi me rregullore të veçantë përcakton strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe mënyrën, kohën, numrin dhe çështje tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.

KAPITULLI VII

Kuvendi i Komunës

Neni 30

1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë i cili zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

2. Kuvendi ka 35 këshilltarë/e.

3. Mandati i çdo këshilltari të Kuvendit të Komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar.

4. Të gjithë këshilltarët e Kuvendit duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

"Betoherm (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

5. Këshilltarët e Kuvendit të Komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtar.

Neni 31

Mandati

1. Mandati i këshilltarëve të Kuvendit të Komunës është katër vite.
2. Këshilltari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar:
 - 2.1. me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
 - 2.2. nëse ai ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
 - 2.3. nëse këshilltari ia paraqet Kryetarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
 - 2.4. nëse këshilltari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
 - 2.5. nëse këshilltari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës pa arsye;
 - 2.6. nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm e diskualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.
3. Këshilltari i Kuvendit të Komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 32

Konfliktet e interesit

1. Këshilltari i Kuvendit të Komunës apo anëtar i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.
2. Çdo këshilltar duhet t'i shfaq të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofroj informacione për interesat e këshilltarit tjetër.
3. Para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, këshilltarët e Kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë shefi i Personelit. Këshilltarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.
4. Rregullorja e punës përfaton masat për përjashtimin e këshilltarit nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku kanë konflikti të interesit.

Neni 33

Të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve të Kuvendit

1. Këshilltarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në punimet e Kuvendit si dhe të kërkojnë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari i Komunës, apo nga kryesuesi i komitetit.
2. Këshilltari i Kuvendit të Komunës mund të dorëzoj vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.
3. Këshilltari i Kuvendit të Komunës mund t'i u drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit të Komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votoj. Ai apo ajo mund t'i propozoj kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.
4. Këshilltari i Kuvendit të Komunës mund të kërkoj nga Kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngritë çështjen në Kuvendin e Komunës.
5. Këshilltari i Kuvendit të Komunës lejohet të mungoj nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen punëve të Kuvendit.

6. Kuvendi i Komunës, në pajtim me Statutin e Komunës dhe me udhëzimet e nxjerra nga Qeveria qendrore, mund t'ia ofrojë kompensim anëtarëve të Kuvendit për punën e tyre në Kuvendin e Komunës.
7. Këshilltarët e Kuvendit të Komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.
8. Kompensimi financiar i kryesuesit, këshilltarëve dhe anëtarëve të komiteteve përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës, në pajtim me aktet përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 34

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, këtij Statuti dhe akteve të tjera nënligjore.
2. Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:
 - 2.1. Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre
 - 2.2. miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
 - 2.3. miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo rregulloreve të punës;
 - 2.4. planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
 - 2.5. themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji;
 - 2.6. zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit;
 - 2.7. nivelit të tarifave dhe ngarkesave;
 - 2.8. krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
 - 2.9. emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
 - 2.10. arrijten e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
 - 2.11. marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
 - 2.12. përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.
3. Për marrjen e vendimeve, Kuvendi mund t'ia delegojë përgjegjësitë e tij komitetit të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Neni 35

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

1. Kuvendi i Komunës e zgjedh kryesuesin e Kuvendit nga radhët e anëtarëve.
2. Kryesuesi i Kuvendit zgjedhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.
3. Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të Kuvendit është me vota të fshehta.
4. Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
5. Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjedhet kryesues i Kuvendit.

6. Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në paragrafin 35.5 të Statutit bazë, shkohet në votimin e tretë.

Në votimin e tretë, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjedhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

7. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës përsëritet.

Neni 36

Mbledhja inauguruese

1. Kuvendi e mban mbledhjen inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Mbledhja inauguruese e Kuvendit thirret nga Kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

3. Nëse Kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit mund të thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur Kryetari është dashur të thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.

4. Nëse anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

5. Mbledhjet e Kuvendit që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit të Komunës kryesohen nga anëtari më i moshuar i Kuvendit që është i pranishëm në mbledhje.

Neni 37

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Kryesuesi i Kuvendit thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit.

2. Kuvendi mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e punës.

3. Të gjithë këshilltarët e Kuvendit duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

3.1. Njoftimi përmban:

- datën e mbajtjes së mbledhjes;
- kohën e mbajtjes së mbledhjes;
- vendin e mbajtjes së mbledhjes;
- tendin e propozuar të dërgohet për mbledhje; dhe
- materialet e mbledhjes,
- të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Rregullore të punës.

4. Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet jenë publike dhe të përgatiten konform dispozitave të Ligjit mbi gjyqësi.

5. Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 38

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve të Kuvendit, apo me kërkesë të Kryetarit.
2. Është drejta për të thirr një mbledhje të jashtëzakonshme gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për mbledhjen e caktuar.
3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
4. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit nuk mbahet nëse të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohej me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.
5. Procedurat që zbatohen për njoftimin dhe për çështje tjera për mbledhjet e rregullta, zbatohen edhe për mbledhjet e jashtëzakonshme.
6. Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 39

Mbledhjet Urgjente

Thirren në rast të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave tjera urgjente në Komunë, Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente të Kuvendit të Komunës. Procedurat për thirrjen e mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve tjera të Kuvendit të Komunës.

Neni 40

Mbledhjet Solemne

Mund të mbahen për raste të veçanta, festa zyrtare shtetërore, festa zyrtare të Komunës dhe solemnitete tjera. Mbledhjet solemne thirren nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës. Mbledhja solemne thirret së paku një (1) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 41

Takimet e hapura

1. Mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjet që janë objekt diskutimi.
2. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit ose komitetit përkatës siguron kushtet dhe mundësitë fizike për pjesëmarrjen e publikut në vendin ku mbahet mbledhja.
3. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit ose komitetit përkatës, nëpërmjet zyrës për informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme.
4. Njoftimi i qytetarëve dhe i subjekteve tjera të interesuara bëhet përmes:
 - Shpalljeve publike,
 - Mediave lokale dhe web faqen zyrtare të Komunës.
5. Njoftimet përmbajnë të dhënat nga neni 37.3 të këtij Statuti.
6. Kryesuesi i Kuvendit e njofton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal 7 ditë para

mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme sipas të dhënave të parapara në paragrafin 4 të këtij neni.

7. Kuvendi, apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:

7.1. mendohet se mbajtja e mbledhjes së hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;

7.2. mbledhja e hapur kërcënon të zbulojë informacione [dhe dokumente], të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare;

7.3. kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale; ose

7.4. informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

8. Në rastet e tilla, Kuvendi i Komunës me vendim bënë arsyetimin për mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

Neni 42

Kuorumi

1. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

2. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi.

Neni 43

Rendi i ditës

1. Rendi i propozuar i ditës për mbledhjen e Kuvendit caktohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

2. Anëtarë i Kuvendit të Komunës mund të kërkoj shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë mbledhjes së rregullt të Kuvendit, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

3. Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

4. Rregullorja e punës së Kuvendit parasheh më afërsisht dispozita për përgatitjen, miratimin dhe ndryshimin e rendit të ditës.

Neni 44

Votimi

1. Në mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve të tij, secili anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

2. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe propozimet e komiteteve të tij, merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, përveç rasteve të caktuara ndryshe me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut.

3. Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 45

Procesverbali

1. Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, mbahet procesverbali. Procesverbali përfshinë emrat e këshilltarëve të pranishëm dhe të anëtarëve të huar, rendin e ditës, theksin e diskutimit, rezultatit numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të

refuzuara. Nëse kërkohet të thirret me emër secili anëtar, në procesverbal shënohet si ka votuar secili.

2. Procesverbalin e mban një nëpunës civil i autorizuar.

3. Procesverbalet mbahen në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve të tij dhe miratohen në mbledhjen e radhës.

4. Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar nga Kuvendi.

Neni 46

Shpërndarja e Kuvendit jofunksionues të Komunës

1. Nëse Kuvendi i Komunës dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, apo nëse bëhet jofunksionuese dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal njofton Komunën për dështimin dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura në mënyrë që të sigurohet kryerje e qetë e funksionit komunal.

2. Kuvendi i Komunës konsiderohet jo funksionues nëse:

2.1. nuk e zgjedh kryesuesin, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;

2.2. nuk miraton statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit;

2.3. nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; ose

2.4. nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj;

3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e Komunës. Qeveria mund ta shpërndajë Kuvendin e Komunës jofunksionues.

4. Zgjedhjet e reja për Kuvendin e Komunës mbahen në pajtim me Ligjin për zgjedhjet komunale.

Neni 47

Komitetet e përhershme

1. Kuvendet komunale themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

2. Kuvendi i Komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësiave të tyre.

3. Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.

Neni 48

Komiteti për Politikë dhe Financa

1. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij reflekton përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës.

2. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 49

Komiteti i komuniteteve

1. Komiteti për komunitete përfaqëson në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga këshilltarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në Komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në Komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të komuniteteve.
2. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Neni 50

Komitetet tjera të përhershme

1. Kuvendi i Komunës themelon edhe komitetet tjera sipas nevojës :
 - 1.1. Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
 - 1.2. Komitetin për Arsimit;
 - 1.3. Komitetin për Zhvillim Ekonomik;
 - 1.4. Komitetin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit;
 - 1.5. Komiteti për Kulturë Rinë dhe Sport;
 - 1.6. Komiteti për Pronë;
 - 1.7. Komiteti për Bujqësi Pylltarë dhe Zhvillim Rural

Neni 51

Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Është përgjegjës për kujdesin shëndetësor primar dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal kujdesin shëndetësor sekondar, për stabilimentet që lidhen me ujin e pijes, kanalizimin , trajtimin e ujërave, grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave, si dhe përkrahjen për shërbime sociale dhe banimin.
2. Këshillon Kuvendin Komunal në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe mbikëqyrë punën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , në çështjet që lidhen me politikat shëndetësore e sociale në Komunë dhe bën rekomandime në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 52

Komiteti për arsim

- Është përgjegjës për fusha që ka të bëjë me edukimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe kopshet e fëmijëve, themelimin dhe funksionimin e institucioneve mësimore. Ky komitet monitoron punën e Drejtorisë së Arsimit, bën rekomandime në bazë të ligjeve në fuqi si dhe merret me çështje tjera në kuadër të fushës së arsimit.

Neni 53

Komiteti për zhvillim ekonomik

1. Është përgjegjës për fushat që kanë të bëjnë me përkrahjen e zhvillimit ekonomik të

Komunës, përfshirë këtu organizimin e panairëve të tregtisë dhe tregjeve, tërheqjen e bizneseve dhe turizmit si dhe për bashkëpunimin e bizneseve në nivelin lokal.

2. Ky komitet mbikëqyrë punën e Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit si dhe bënë rekomandime me ligjet në fuqi.

Neni 54

Komiteti për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit

1. Është përgjegjës për planet hapësinore të përgjithshme e specifike për zonat urbane dhe rurale, përfshirë këtu çështjet që lidhen me banimin, ndërtesat publike, turizmin, mbrojtjen e mjedisit, zonat për shfrytëzim publik sikur që janë parqet, fushat e gjelbëruara dhe hapësirat rekreative, sheshet e lojërave si dhe transporti publik.

2. Ky komitet ndihmon Kuvendin Komunal në hartimin dhe miratimin e rregulloreve për këto fusha: lëvizjet e trafikut, parkingjet, ndërtimet, lëshimi i lejeve ndërtimore, standardet e mirëmbajtjes, rrugët komunale dhe vendkalimet për këmbësor, identifikimin e veçorive të interesit natyror, historik e mjedisor, përfshirë këtu mbrojtjen e tyre, emërtimin e rrugëve komunale dhe vendeve tjera publike.

3. Ky komitet mbikëqyrë punën e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në çështjet që kanë të bëjnë me politikat mjedisore në Komunë si dhe bënë rekomandime në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 55

Komiteti për Kulturë Rinë dhe Sport

Është përgjegjës për fushën që ka të bëjë me Kulturën Rinë dhe Sportin në Komunën e Podujevës, lidhur me funksionimin e objekteve sportive dhe kulturore siç janë Teatri, biblioteka, kinematë komunale, stadiumet sportive e të tjera të ngjashme. Ky Komitet monitoron punën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për çështjet që kanë të bëjnë me politikat kulturore, rinore dhe sportive dhe të bëjë rekomandime për fushat në fjalë.

Neni 56

Komiteti për Pronë

Është përgjegjës për fushën që ka të bëjë me pronën, duke mos u kufizuar edhe për fushën që ka të bëjë me kadastrin dhe gjeodezinë, lidhur me banimin, ndërtesat publike, shfrytëzimin dhe menaxhimin e pronave publike dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë. Ky Komitet monitoron punën e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë për çështje që kanë të bëjnë me politikat që janë në kompetencë dhe fushëveprimtarë të kësaj Drejtorie.

Neni 57

Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Është përgjegjës për fushën që ka të bëjë me bujqësinë pylltarinë dhe zhvillimin rural, lidhur me ngritjen, avancimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore të bujqësisë, rruajtjen dhe mbrojtjen e pylltarisë si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin rural në territorin e Komunës. Ky Komitet monitoron punën e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për çështje që janë në kompetencë dhe fushëveprimtarë të kësaj Drejtorie.

Neni 58

1. Komitetet tjera të përherëshme nga neni 47 të Statutit në përbërje të vet numërojnë nga 7 anëtarë.
2. Në përbërje të komiteteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni mund të caktohen edhe anëtar nga shoqëria civile, por shumica e anëtarëve të tyre duhet të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës.
3. Anëtarësia e komiteteve të cekura duhet të pasqyrojë përpjesëtimin e numrit të ulësve që mbahen nga subjektet politike në Kuvendin e Komunës.
4. Kuvendi i Komunës, në kuadër të kompetencave miraton Rregulloren për përgjegjësitë dhe fushëveprimtarinë e komiteteve.

KAPITULLI VIII

Udhëheqësia komunale - Ekzekutivi

Neni 59

Zgjedhja e Kryetarit të Komunës

1. Kryetari i Komunës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejtë në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.
2. Kryetari i Komunës zgjidhet për një periudhë katërvjeçare.
3. Mandati i Kryetarit të Komunës përfundon:
 - 3.1. kur ta kryejë mandatin e tij;
 - 3.2. nëse vdes;
 - 3.3. nëse jep dorëheqje;
 - 3.4. nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
 - 3.5. nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
 - 3.6. nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;
 - 3.7. në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon Kryetarin e Komunës nga cilësia juridike; dhe
 - 3.8. në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Neni 60

Betimi

1. Me rastin e zgjedhjes, Kryetari e jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
Teksti i betimit është si në vijim:
"Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Podujevës me nderë, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë."
2. Kryetari që dështon ta japë betimin brenda një (1) muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, humb mandatin.

Neni 61

Përgjegjësitë e Kryetarit

1. Kryetari i Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:
 - 1.1. përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
 - 1.2. udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
 - 1.3. ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
 - 1.4. ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
 - 1.5. emëron apo shkarkon nënkryetarin e tij/saj;
 - 1.6. emëron dhe shkarkon drejtorët të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
 - 1.7. organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
 - 1.8. propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
 - 1.9. propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
 - 1.10. raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës; dhe
 - 1.11. mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve; dhe
 - 1.12. Aktivitetet tjera që i caktohen me Statut.

Neni 62

Konflikti i interesit

1. Menjëherë pas zgjedhjes së tij, Kryetari i Komunës ndërpret çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje afësinë e tij për kryerjen e përgjegjësisë së tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
2. Kryetari i Komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo financiar.
3. Nga Kryetari i Komunës kërkohet t'i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.
4. Kryetari i Komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i Komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

Neni 63

Nënkryetari i Komunës

1. Kryetari i Komunës ka një Nënkryetar i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari për të njëjtin mandat.
2. Me kërkesë të Kryetarit, Nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.
3. Kur posti i Nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron Nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë.
4. Për konfliktin e interesit për Nënkryetarin zbatohen përshtatshmërisht dispozitat nga neni 62 të këtij Statuti.

Neni 64

Drejtoria e Administratës komunale

1. Administrata komunale organizohet në Drejtori.
2. Komuna ka këto Drejtori:
 - 2.1. Drejtoria e Administratës
 - 2.2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
 - 2.3. Drejtoria e Arsimit
 - 2.4. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
 - 2.5. Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
 - 2.6. Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
 - 2.7. Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
 - 2.8. Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
 - 2.9. Drejtoria e Inspeksionit
 - 2.10. Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 - 2.11. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Çdo Drejtori menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari.
4. Drejtoret menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë përkatëse në përputhje me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi dhe udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit.
5. Drejtoret i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
6. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është pjesë përbërëse e strukturës organizative të Administratës së Komunës.

Neni 65

Konflikti i interesit për drejtoret

1. Drejtori përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çështjen për të cilën ai/ajo apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.
2. Drejtoret janë të detyruar që çdo konflikti i interesit ta paraqesin me shkrim.
3. Në rastet e konfliktit të interesit të drejtorit në çështjet e cekura si në paragrafin 1 të këtij neni Kryetari i Komunës në vend të tij cakton një drejtor tjetër.
4. Rregullorja e punës më afërsisht parasheh masat që do të ndërmerren në përjashtimin e drejtorit nga vendimmarrja dhe procedura administrative kur paraqitet konflikti i interesit.

Neni 66

Shkarkimi i Kryetarit

1. Kryetari i Komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej 30 ditëve, nëse Kryetari ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.
2. Nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për suspendimin nga detyra të Kryetarit të Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës suspendimin e Kryetarit. Qeveria e Republikës së Kosovës (brenda 30 ditëve) mund të suspendojë me vendim Kryetarin e Komunës dhe t'i dorëzojë lëndën Gjykatës kushtetuese.
3. Nëse Gjykata kushtetuese e përkeqëson vendimin Qeveria mund shkarkojë nga detyra Kryetarin.

KAPITULLI IX

Administrata komunale

Neni 67

Shërbimi civil i Komunës

1. Shërbimi civil i Komunës përfshinë të punësuarit nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

1.1. Kryetarit, Nënkyetarit/ve dhe drejtorëve komunal;

1.2. kryesuesit, dhe të gjithë këshilltarëve të Kuvendit të Komunës;

2. Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e Komunës dhe nëpunësit civil të administratës së Komunës nuk mund të jenë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës ku ata punojnë.

3. Sistematizimi dhe përshkrimi i vendeve të punës të nëpunësve civilë në kuadër të Komunës, rregullohet me akt të veçantë të Kryetarit të Komunës.

4. Zgjedhjet për Kuvendin e Komunës nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesve civilë.

Neni 68

Udhëheqësi i personelit

1. Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit.

2. Kryetari shpall, rekruton dhe largon udhëheqësin e personelit në pajtim me ligjin e aplikueshëm për Shërbim civil.

3. Nëse posti i udhëheqësit të personelit mbetet i zbrazët, Kryetari i Komunës emëron një anëtar të lartë të Shërbimit civil komunal në cilësinë e kryesit të detyrës së udhëheqësit të personelit.

4. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, Kryetari rekruton udhëheqësin e personelit në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 69

Konflikti i interesit

1. Nëpunësi civil i Komunës përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal ose financiar.

2. Në rastet e konfliktit të interesit të shërbyesit civil në çështjen e vendimmarrjes apo zhvillimit të procedurës administrative drejtori i Drejtorisë përkatëse në vend të tij për çështjet e cekura cakton një shërbyes tjetër civil.

Neni 70

Zyrat e Gjendjes Civile

1. Me qëllim të plotësimit të nevojave, përkatësisht ofrimit të shërbimeve qytetarëve të saj, Komuna në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësiive ligjore, themelon Zyra të Gjendjes Civile.

2. Komuna mban kontrollin e plotë në të gjitha fushat e kompetencës së saj të de-koncentruar në Zyrat e Gjendjes Civile.

3. Zyrat e Gjendjes Civile janë pjesë përbërëse dhe funksionojnë në kuadër të Administratës së Komunës. Të njëjtat drejtohen nga personeli i cili caktohet nga Administrata e Komunës.

4. Zyrat e Gjendjes Civile themelohen me vendim të Kuvendit. Një Zyrë mund të themelohet për dy apo më shumë Zona kadastrale. Zyra të cekura sipas nevojës mund të themelohen edhe në pjesë tjera të qytetit.

5. Funksionimi i zyrave të vendit bëhet nga mjetet buxhetore të ndara nga Ekzekutivi i Komunës.

KAPITULLI X

Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve

Neni 71

Informimi publik dhe konsultimi

1. Komuna mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.
2. Në takime të tilla përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e Komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.
3. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, Komuna është e obliguar t'i informojnë qytetarët e Komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç janë të parapara me Statutin e Komunës.
4. Kuvendi i Komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të Komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të Komunës.
5. Qytetari mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga Komuna, përveç rasteve që janë të ndaluara sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 72

Kërkesat për informim dhe peticionet

1. Çdo person ose organizatë e interesuar ka të drejtë të parashtoj kërkesë për informacion për veprimtarinë e Komunës ose t'i drejtoj peticion Kuvendit të Komunës, për çështjet që janë përgjegjësi e Komunës. Kërkesat ose peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit të përcaktuar me ligj.
2. Pas diskutimit në Kuvend, Kryetari i Komunës ose një zyrtar i autorizuar prej tij, jo më vonë se 30 ditë nga data e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.
3. Në rastet kur peticioni lidhet me çështje për të cilat Komuna nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Komunës ose një zyrtar i autorizuar prej tij, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit se është jokompetent dhe e procedon atë tek organi kompetent duke informuar edhe parashtruesin.

Neni 73

Referendumi

1. Qytetarët e Komunës mund të kërkojnë që rregullorja e Kuvendit të Komunës e miratuar nga Kuvendi i Komunës, t'i nënshtrohet referendumit.
2. Kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit të Komunës, brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar.
3. Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtoj kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit, në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 74

Iniciativa e qytetarëve

1. Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të Komunës, për miratim nga Kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.
2. Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
3. Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës.
4. Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtoj rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Neni 75

Largimi i Kryetarit

1. Qytetarët e Komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e Kryetarit të Komunës.
2. Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzetë (20) për qind e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit të Komunës. I cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.
3. Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e Kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të bëhen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet.

Neni 76

Komitetet konsultative

1. Kuvendi i Komunës themelon Komitete Konsultative në propozim të Kryetarit të Komunës, anëtarëve të Kuvendit dhe OJQ-ve / Shoqërisë civile, dhe janë trupa ndihmës të Kuvendit dhe roli i tyre është ndihmë organet e Komunës të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.
2. Komitetet Konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve / Shoqërisë Civile të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse, të cilët përzgjidhen sipas konkursit publik të shpallur nga Kuvendi i Komunës pas propozimit të Panelit Përzgjedhës të themeluar nga Kuvendi.
3. Mandati i Komiteteve Konsultative është 4 vjet nga themelimi. Kuvendi i Komunës mund të themeloj edhe Komitete Konsultative ad-hoc për çështje të caktuara.
4. Numri i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 5 deri në 7 anëtarë, dhe duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor.
5. Komitetet mbajnë mbledhje sipas nevojës, por jo më pak se 6 takime në vit.
6. Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushveprimtarit e ndryshme në pajtim me këtë Statut, përfshirë, për rregullore të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Kuvendit dhe Komiteteve të përhershme, paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendi i Komunës, japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara dhe çështje tjera me nevojë të cilat duhet të merren parasysh nga Kuvendi i Komunës për zhvillimin e politikave lokale.
7. Komitetet Konsultative obligohen të dorëzojnë në Kuvendin e Komunës, raport vjetor për punën e tyre.

Neni 77

Komisionet ad hoc

1. Kuvendi për shqyrtimin e çështjeve të caktuara mund të ngritë edhe Komisione ad hoc.
2. Mandati i Komisioneve ad hoc pushon pas zgjidhjes së çështjes.

Neni 78

Transparenca

1. Aktet normative të Kuvendit të Komunës ose organeve të tjera komunale, përfshirë, rregulloret, buxhetin e Komunës dhe vendimet, i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit.
2. Organi përgjegjës përgatit projekt-aktin dhe cakton mënyrën e zhvillimit të diskutimit, afatin e konsultimit duke përfshirë në mënyrë të detyrueshme diskutime me grupet e interesit, seancat dëgjimore me publikun dhe forma të tjera të pjesëmarrjes së publikut.
3. Zyra për informim dy javë para seancës së diskutimit publik njofton publikun përmes:
 - shpalljeve publike
 - mediave lokale
 - web faqes zyrtare të Komunës.

Neni 79

1. Aktet normative të Kuvendit të Komunës bëhen publike konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, përveç atyre publikimi i të cilave kufizohet me legjislacionin për qasje në dokumente zyrtare.
2. Publikimin e akteve nga paragrafi 1 i këtij neni e bën Zyra për informim përmes mjeteve të informimit.
3. Buxheti komunal dhe plani komunal janë dokumente publike. Komuna rimbursimet e saj me masa për t'i vënë këto dokumente në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe palëve të interesuara në formë të plotë ose të shkurtuar sipas kërkesës.

Neni 80

1. Komunitat garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare të Komunës.
2. Njësia apo zyrtari përgjegjës për komunikim me qytetarë, obligohet të veprojë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 81

Kuvendi i Komunës duhet të miratojë planin e veprimit dhe Rregulloren komunale për transparencë, me qëllim që procesi i vendimmarrjes dhe veprimtaria e organeve të Komunës të bëhet me transparente.

KAPITULLI XI

Marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë qendrore dhe lokale

Neni 82

Objektivat e Komunës në shqyrtimin administrativ

1. Shqyrtimi administrativ i Komunës ka objektivat vijues:
 - 1.1. të forcoj aftësinë e organeve të vetëqeverisjes lokale në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre përmes këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës;
 - 1.2. të siguroj ligjshmëri të aktivitetëve të organeve të vetëqeverisjes lokale; dhe
 - 1.3. të siguroj që të respektohen të drejtat dhe interesat e qytetarëve

Neni 83

Parimet themelore të shqyrtimit administrativ

1. Shqyrtimi administrativ i akteve të Komunës ushtrohet në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin.
2. Nuk mund të ushtrohet ndonjë shqyrtim paraprak nëse nuk parashihet ndryshe me ligjin dhe këtë Statut.
3. Shqyrtimi administrativ duhet të ketë sa më pak, që të jetë e mundur, ndikim në interesat e vetëqeverisjes lokale dhe nuk duhet të kufizojë të drejtën e autoriteteve lokale në menaxhimin e çështjeve publike që bien në fushën e autoritetit të tyre, në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.
4. Intervenimi i autoritetit mbikëqyrës duhet të jetë proporcional me rëndësinë e interesave të cilat synon t'i mbrojt.

Neni 84

Autoriteti mbikëqyrës

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për funksionimin dhe mbikëqyrjen për qeverisjen lokale, nëse kjo përgjegjësi nuk bartet me ligj në ndonjë institucion tjetër.
2. Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i Qeverisë qendrore që i ka deleguar ato.

Neni 85

Përgjegjësitë e ndërsjella dhe procesi i shqyrtimit administrativ

1. Organet e Komunës dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal detyrohen që të bashkëpunojnë për çështjet që janë objekt i shqyrtimit administrativ.
2. Masat e shqyrtimit administrativ ndërmerren nga autoritetet mbikëqyrëse në bazë të akteve përkatëse administrative. Aktet e tilla ofrojnë bazën ligjore dhe arsyet e zbatimit të masës së një mbikëqyrjeje të caktuar.

Neni 86

Të drejtat e autoritetit mbikëqyrës për të qenë të informuar

1. Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të sigurojë informata të plota për të gjitha çështjet, përfshirë të drejtën për t'i vizituar zyrat komunale dhe objektet komunale dhe të drejtën për të kërkuar qasje në dokumentet komunale.

2. Gjatë vizitave të tilla, përfaqësuesit e autoritetit mbikëqyrës nuk i japin ndihzime të drejtpërdrejta stafit të organeve lokale vetëqeverisëse. Çdo kërkesë për dokumente i adresohet organit të qeverisjes lokale dhe shpërndarja e dokumenteve sigurohet nga Kryetari i Komunës në pajtim me paragrafin 1 të nenit 85 të këtij Statuti.
3. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale ka të drejtën për të qenë e informuar rregullisht nga komunat në fushat në të cilat ministria nuk është autoritet mbikëqyrës.
4. Kryetari i Komunës është përgjegjës për t'ia vënë në dispozicion informacionet autoritetit mbikëqyrës.

Neni 87

Llojet e shqyrtimit

1. Shqyrtimi i funksionimit të komunave në fushën e kompetencave vetanake kufizohet në shqyrtimin e ligjshmërisë.
2. Shqyrtimi administrativ i funksionimit të komunave në fushën e kompetencave të deleguara i nënshtrohet mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe përshatshmërisë së veprimeve.

Neni 88

Shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë

1. Kryetari i Komunës i dërgon autoritetit mbikëqyrës listën e të gjitha akteve të miratuara nga Kryetari dhe Kuvendi për muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji vijues.
2. Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të mbikëqyrë çdo akt i cili nuk është kontrolluar sipas procedurave të shqyrtimit të detyrueshëm, brenda 30 ditësh pas pranimit të listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 89

Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë

1. Procedurës së shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë i nënshtrohen aktet si vijon:
 - 1.1. aktet e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi i Komunës;
 - 1.2. vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta të partneriteteve për bashkëpunim;
 - 1.3. Aktet e miratuara brenda kornizës së implementimit të kompetencave të deleguara.
2. Komuna obligohet që t'ia dorëzojnë aktet e përmendura autoritetit mbikëqyrës brenda 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së tyre.
3. Autoriteti mbikëqyrës vërteton pranimin e aktit të Qeverisë lokale përmes regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës.
4. Autoriteti mbikëqyrës obligohet që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë.

Neni 90

Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë

1. Nëse autoriteti mbikëqyrës konsideron se një vendim apo një akt i Komunës nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjet, mund të kërkojë që Komuna ta rishqyrtojë vendimin apo aktin e tillë. Kërkesa e Autoritetit mbikëqyrës duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkeljes së Kushtetutës apo ligjit dhe nuk pezullon ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve të tjera.

2. Organi i Komunës i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës.
3. Nëse Komuna pranon kërkesën për rishqyrtim, ajo mund të suspendojë ekzekutimin e vendimit të kontestuar apo aktit deri në shqyrtimin e saj nga autoritetet lokale.
4. Nëse Komuna nuk përgjigjet brenda afatit apo refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtoj aktin në fjalë në Gjykatën Kompetente për territorin e Komunës, brenda 30 ditësh pas dështimit për t'iu përgjigjur njoftimit për refuzimin apo mbështetjen e vendimit apo aktit të kontestuar.
5. Gjykata Kompetente mund të urdhërojë, si masë të përkohshme, suspendimin e zbatimit të vendimit apo aktit të kontestuar apo akteve të tjera të përkohshme në pajtim me ligjin në zbatim.

Neni 91

Kërkesa për konsultim paraprak

1. Para nxjerrjes së një akti, organi komunal mund të kërkojë konsultim me autoritetin mbikëqyrës.
2. Kërkesa për konsultime paraprake përmban draftin e aktit që synohet të nxirret dhe qëshihen e posaçme për të cilën kërkohet këshilla e autoritetit mbikëqyrës për sa i përket ligjshmërisë dhe/ose arsyeshmërisë së aktit në fjalë.
3. Autoriteti mbikëqyrës obligohet të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditësh pas pranimit të kërkesës.

Neni 92

Shqyrtimi i përshtatshmërisë

1. Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes së kompetencave të deleguara ka të drejtë të kërkojë, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të kopjes së aktit, që organi komunal ta modifikojë apo shfuqizoj aktin e kontestuar në bazë të shqyrtimit të përshtatshmërisë.
2. Nëse organi komunal nuk vepron sipas kërkesës, organi mbikëqyrës përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes së përshtatshmërisë mund ta modifikojë, zëvendësojë aktin, apo pezullojë ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve të tjera.
3. Autoriteti mbikëqyrës informon organin komunal për vendimin e marrë, brenda 5 ditësh nga data e miratimit të vendimit.

Neni 93

Ankesat e qytetarëve

Ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve të komunës shqyrtohen sipas Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative në fuqi.